



## **PARAQITJE NË KOMISIONIN E EKONOMISË, FINANCAVE DHE TË PRIVATIZIMIT, 8 DHJETOR 1999.**

### **I. TË PËRGJITHSHME**

Të nderuar deputetë,

Jam sot përpara jush për të diskutuar dhe për të raportuar mbi zhvillimet ekonomike, monetare, valutore e bankare gjatë vitit 1999, realizimin e objektivave si dhe parashikimin e tyre për vitin 2000.

Nga zhvillimet e vërejtura deri më tash vlerësohet se realizimi i objektivave finalë të programit ESAF për vitin 1999 është praktikisht i arritur.

Në tërësi gjykohet se do të realizohet objekivi i rritjes ekonomike, do të realizohen të tre objektivat sasiore që ndjek Banka e Shqipërisë në lidhje me politikën monetare, do të respektohen kufijtë e vendosur për deficitin buxhetor dhe financimin me burime të brendshme të tij, niveli i inflacionit vjetor në fund të vitit do të jetë shumë poshtë objektivit të vendosur dhe deficitin i llogarisë korente në raport me PBB-në pritet të ketë një nivel më optimist se ai i parashikuar. Tashmë mund të them me bindje të plotë se në tërësi ngjarjet e periudhës prill-qershor të këtij viti, nuk e keqësuan situatën ekonomike ashtu siç e parashikuam në fillim të konfliktit. Ndihma e menjëhershme dhe bujare e Komunitetit Ndërkombëtar e lehtësoi barrën që u krijua.

Nga ana tjetër, kthesa që morën ngjarjet i hapi perspektiva të tjera Shqipërisë nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik. Është mëse e mjaftueshme të përmenden Pakti i Stabilitetit për rajonin e Ballkanit si dhe krijimi i hapësirës së re për aktivitet ekonomik në Veri të Republikës së Shqipërisë. Stabiliteti relativ makroekonomik dhe politik i arritur gjatë këtyre dy viteve duhet të na shërbejë si bazë për të parë më me optimizëm vitin 2000. Këto ide materializojnë objektivat e vendosur për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, vëmendja në të ardhmen duhet përqendruar në ato çështje të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje deri më sot dhe që përbëjnë kërcënim për stabilitetin e vendit.

## II. SITUATA MAKROEKONOMIKE

### 2.1. Rritja e prodhimit.

**Banka e Shqipërisë vlerëson se për vitin 1999 do të realizohet objektivi i vendosur për rritjen ekonomike prej 8 për qind.** Vetë *struktura e ekonomisë shqiptare e favorizon këtë gjë.* Prodhimi kombëtar është bazuar kryesisht tek prodhimi bujqësor, një sektor më i imunizuar qoftë nga tronditjet e brendshme dhe ato të jashtme, tek sektori i shërbimeve, i transportit dhe i ndërtimit. *Sektorët e ekonomisë, të cilët u prekën më së shumti nga konflikti i pranverës, kanë peshë relativisht të ulët. Nga ana tjetër, ishte mjaft i dukshëm efekti i zëvendësimit.* Dëmi i pësuar në disa degë u zëvendësua me gjallërimin e disa të tjerave. Drejtpërdrejt si pasojë e konfliktit, u regjistruan zhvillime të rëndësishme në sektorin e shërbimeve, në ndërtim etj..

Rritja e mundshme në nivelin 8 për qind në terma realë argumentohet me veprimin e disa faktorëve, ndër të cilët do të veçonim:

- Duke ju referuar të dhënave të pakta të disponueshme, vërehet se aktiviteti industrial, gjatë tremujorit të tretë, vazhdon të ruajë thuajse të njëjtat ritme si dhe në tremujorët paraardhës. Prodhimi mall i shitur i realizuar deri në fund të muajit shtator të këtij viti, i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar shënon një rënie prej rreth 6.7 për qind. Megjithatë, duke gjykuar nga pesha e ulët që zë sektori shtetëror në prodhimin industrial të vendit dhe vetë prodhimi industrial në strukturën e prodhimit kombëtar (rreth 10 - 15 për qind në vitin 1997), nuk pritet një ndikim i ndjeshëm në rritjen ekonomike të vendit. Nga një analizë e shkurtër e sektorëve industrialë vërehet se dobësitë më të mëdha mbeten në sektorin minerar, veçanërisht në industrinë e bakrit dhe të kromit, ku nuk po arrihet as gjysma e aktivitetit ekonomik të realizuar nga ky sektor gjatë vitit të kaluar. Me përjashtim të sektorit të energjisë elektrike, e cila vazhdon të ruajë dinamizmin e prodhimit, në nivele të dobëta vazhdojnë të qëndrojnë edhe prodhimi i çimentos, i materialeve të tjera të ndërtimit, industria metalurgjike etj.. Duket se procesi i privatizimit dhe i ristrukturimit të disa prej këtyre sektorëve (siç është rasti i Kombinatit Metalurgjik) akoma nuk kanë filluar të japin efektet e tyre.
- \* Duke gjykuar nga treguesi i konsumit të çimentos, vërehet se sektori i ndërtimit vazhdon të ruajë dinamikën e rritjes. Kjo ecuri e sektorit të ndërtimit besohet se është rrjedhojë kryesisht e gjallërimit të projekteve publike të financuara nga Komuniteti Ndërkombëtar dhe



nga NATO, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, e konsolidimit gjithnjë e më tepër të sektorit privat të angazhuar në biznesin e ndërtimit.

- Bujqësia mund të thuhet se mbeti e paprekur nga zhvillimet e ndodhura dhe vazhdon të ruajë ritmet e saj konstante të rritjes duke siguruar dhe bazën kryesore në rritjen e prodhimit të përgjithshëm. Pikërisht kjo degë e ekonomisë (që përfaqëson mbi 50 për qind të PBB-së) siguron edhe arritjen e objektivit.
- Duke gjykuar nga të dhënat e eksporteve, vërehet se aktiviteti ekonomik i firmave të huaja në sektorët e industrive tekstile, lëkurë-këpucëve dhe drurit ka vazhduar të ruajë ritmet normale, madje mund të flitet për një shfrytëzim më të madh të kapaciteteve të tyre. Eksportet për nëntëmujorin e vitit 1999 janë rritur me 42.5 për qind në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ndërkohë që importet kanë shënuar një ritëm më të ulët rritjeje, vetëm 20.4 për qind. Po kështu, në totalin e eksporteve është rritur pesha e rieksperteve në masën 66 për qind nga 59 për qind që ishte një vit më parë.

## 2.2. Punësimi dhe të ardhurat.

Të dhënat zyrtare të nivelit të papunësisë flasin për një nivel relativisht të lartë, që ka arritur nivelin e vitit 1994. Gjatë periudhës qershor 1997-shtator 1999, numri i të papunëve u rrit me 63608 persona. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 1999 përqindja e papunësisë shënoi 18 për qind, po në të njëjtin nivel me tremujorin e dytë, por më i lartë se tremujori i parë i cili shënoi 17,5 për qind.

Për fat të keq, është e pamundur të gjykosh mbi saktësinë e kësaj shifre. Megjithatë, gjykohet se niveli pothuaj relativisht i ulët i investimeve, të huaja dhe publike, mosrealizimi i thithjes së ndihmave e kredive (për gjashtë muajt e parë të vitit është thithur vetëm 38.7 për qind e planit vjetor) dhe, nga ana tjetër, shkurtimi i administratës publike, kanë çuar në rritjen e shifrës zyrtare të papunësisë. E theksoj shifrën zyrtare pasi zhvillimet e tremujorit të dytë të vitit, angazhimet e NATO-s në rehabilitimin e infrastrukturës shqiptare, ushtrimi i veprimtarisë nga dhjetra organizata ndërkombëtare humanitare dhe media të huaja, krijuan vende të reja pune për shoferë, përkthyes, punëtorë ndërtim-shkarkimi etj..

Paga e punonjësve të punësuar në aktivitetet e mësipërme kalonte disa herë pagën mesatare të vendit. Nga ana tjetër, rritje kanë pësuar edhe të ardhurat në sektorin publik (10 për qind në terma nominalë) si pasojë e shfuqizimit të vendimit të marrë në tremujorin e parë të vitit 1999 mbi

bllokimin e shpenzimeve për administratën publike dhe investimet. Në terma realë (domethënë duke marrë parasysh ecurinë e çmimeve të mallrave të konsumit) rritja reale është më e lartë.

Megjithatë, gjatë vitit 1999, si pasojë e sigurimit të të ardhurave të paparashikuara dhe e vlerësimit të monedhës kombëtare, më e theksuar ka qenë prirja drejt konsumit, duke pakësuar në këtë mënyrë atë pjesë të të ardhurave që duhet të investohet për të ardhmen.

### 2.3. Zhvillimet në inflacion.

*“Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve”*, siç mund ta dini, është objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë. Çdo detyrë apo objektivi tjetër i saj do të përcaktohet në funksion të objektivit kryesor.

Ky objektivi materializohet në ecurinë e indeksit të çmimeve të konsumit. Vazhdimisht Banka e Shqipërisë ka synuar arritjen e niveleve të ulëta të këtij indeksi dhe ruajtjen e këtyre niveleve. Për periudhën 1998 - 1999 mund të themi se kemi qenë të suksesshëm në këtë drejtim. Norma vjetore e inflacionit në fund të vitit 1998 ra në 8.7 për qind nga 42 për qind në fund të vitit 1997.

Ndërsa, gjatë vitit 1999 ecuria e çmimeve të konsumit ka qenë e pazakontë. Them e pazakontë sepse për rreth 9 vjet tranzicion asnjëherë nuk është verifikuar një përqindje vjetore në nivele negative për muaj me rradhë. Kështu, në fund të shtatorit norma vjetore e inflacionit arriti në -1.9 për qind, duke u ndjekur nga një përqindje tjetër negative në nivelin -1.8 në muajin tetor. Nisur nga këto zhvillime, **Banka e Shqipërisë deklaroi se është realizuar objektivi i përcaktuar për inflacionin. Sipas vlerësimeve norma vjetore në fund të vitit 1999 mund të arrijë në -1 për qind.**

Niveli i ulët i inflacionit pasqyron në vetvete një ecuri pozitive të të gjithë faktorëve themelorë që e ndikojnë atë. Më konkretisht, i gjithë ambjenti makroekonomik i vendit paraqitet më i stabilizuar si pasojë e shmangies së çdo ekspansioni të mundshëm. I ndjeshëm ka qenë dhe veprimi i faktorëve rastësorë.

- \* Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë i ka shërbyer qëllimit të respektimit të objektivit për inflacionin.
- \* Monedha shqiptare është paraqitur e qëndrueshme në raport me monedhat e huaja, madje me tendencë vlerësimi. Kjo qëndrueshmëri është vërejtur për shumë muaj tashmë dhe ndikim të konsiderueshëm



- kanë patur hyrjet e mëdha valutore si pasojë e konfliktit.
- \* Zhvillimet fiskale janë mbajtur nën kontroll në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 1999. Kostoja e shkaktuar nga popullsia e shpërngulur u përballua me ndihmat e komunitetit ndërkombëtar.
  - \* Normat e interesave për depozitat kanë qenë pozitive në terma realë duke bërë që popullsia të jetë e interesuar për depozitim dhe duke ulur kështu presionet për inflacion.
  - \* Inflacioni i importuar ka qenë më i ulët se sa i parashikuari.
  - \* Kanë qenë të kufizuara aktivitetet e kreditimit, investimit publik etj., duke kufizuar presionet inflacioniste.
  - \* Pritja e popullsisë së shpërngulur nga Kosova u shoqërua me hyrje të konsiderueshme mallrash dhe valute duke bërë që të mos ndihej kërkesa e shtuar, madje të tejkalohet kjo kërkesë.
  - \* Ulja e vazhdueshme e inflacionit gjatë vitit 1998 e sidomos në çdo muaj të vitit 1999 që orienton sjelljen konsumatore.

#### **2.4. Bilanci i pagesave.**

Gjatë vitit 1999, fenomeni më tipik në zhvillimet e bilancit të pagesave ka të bëjë, siç e theksova më lart, me prurjet e mëdha valutore nga jashtë, në një numër të madh formash dhe mënyrash.

Pasoja e drejtpërdrejtë e këtyre prurjeve ka qenë ruajtja e ekuilibrit në pozicionin e jashtëm të vendit, gjë që ka çuar në rivlerësimin e vazhdueshëm të monedhës kombëtare gjatë gjithë periudhës nëntëmuajore.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, për periudhën prill - fillimi i shtatorit në tregun valutor shqiptar ka hyrë valutë në masën 300 milionë dollarë amerikanë (pa marrë parasysh pagat dhe qiratë dhënë rezidentëve në valutë). Qeverisë Shqiptare i janë disbursuar 110 milionë dollarë amerikanë për të mbuluar koston fiskale të shkaktuar nga konflikti. Rreth 100 milionë dollarë të tjerë kanë hyrë si pasojë e shpenzimeve të përditshme, kryesisht për ushqim e veshje, të kryera nga kosovarët. Organizatat humanitare, NATO, punonjës të mediave të huaja, gjithashtu, vlerësohet të kenë prurë rreth 90 milionë dollarë, në formë qirash, pagash për shqiptarët apo shpenzimesh të tjera vetiake.

Si pasojë, deficitin e llogarisë korente besohet të ketë një përmirësim të lehtë në raport me parashikimin e bërë në fillim të vitit. Kjo, për arsye se faktorët që ndikuan në përmirësimin e llogarisë korente në tremujorin e dytë të vitit, për pjesën e mbetur të tij do të pushojnë së vepruari ose do

të jenë fare minimalë.

Importet parashikohet të arrijnë mbi 950 milionë dollarë amerikanë (përfshirë ndihmat për të shpërngulurit), eksporti nuk do të ketë ndryshime, por, ndoshta, vetëm një përmirësim, pasi shihet që në strukturën e eksporteve për këtë vit është shfaqur edhe një zë i ri grupmali, riekportet për produktet elektronike, krahas riekporteve tradicionale, këpucë e tekstile. Gjithashtu, pjesa e mbetur e vitit, sidomos ky tremujor, do të shoqërohet me rritje importesh. Kjo do të thellojë deficitin tregtar duke kompensuar përmirësimin e llogarisë korente në gjashtëmujorin e parë.

## **2.5. Zhvillimet valutore.**

Gjatë vitit 1999, monedha shqiptare është forcuar në këmbimin e saj me valutat kryesore që tregtohen në tregun e brendshëm si pasojë kryesisht e:

- \* Politikës së matur dhe të shtrënguar monetare të Bankës së Shqipërisë. Normat relativisht të larta të interesit nominal dhe real në fillim të vitit që ofronin investimet në bonot e thesarit në lekë (në nivelin 20-25 për qind) rritën kërkesën për lekë. Reduktimi i vazhdueshëm i normës së interesit i shërben uljes së çmimit të monedhës kombëtare për të kompensuar forcimin artificial të saj. Por, rënia më e shpejtë e nivelit të inflacionit, mban ende të lartë normën reale të interesit që fitohet nga investimet në lekë, duke ruajtur atraktivitetin e tyre.
- \* Politikës së shtrënguar fiskale dhe mbajtjes së një deficiti më të ulët se sa ai i planifikuar duke ulur presionet inflacioniste.
- \* Hyrjeve të konsiderueshme në valutë dhe mall si pasojë e ngjarjeve të pranverës (siç është theksuar dhe më lart).
- \* Klimës sociale të qetë brenda vendit, e cila ndikoi në krijimin e një psikologjie për zhvillime normale në vend.
- \* Rritjes së rolit të sistemit bankar në tregun e brendshëm valutore duke ndikuar në rritjen e transaksioneve valutore që kryhen përmes sistemit bankar si dhe duke mos krijuar pozicione të hapura në valutë. Kjo ka ndikuar në zgjerimin e tregut të brendshëm valutore, dhe indirekt në uljen e shkallës së ndryshimit të kursit të këmbimit të lekut.
- \* Ecurisë së kurseve të këmbimit në tregjet ndërkombëtare të këmbimeve valutore, që ka manifestuar një forcim të dollarit amerikan. Kjo ka nxitur në tregun e brendshëm rënien e valutave në nivele më të ulëta, në kushtet e një kërkesë të dobët për valutë.



### **III. ZHVILLIMET MONETARE**

Në zbatim të nenit 161 të Kushtetutës dhe klauzolave të ligjit në fuqi për Bankën e Shqipërisë, dhe në funksion të objektivit të saj kryesor, Banka e Shqipërisë harton dhe miraton politikën monetare.

Gjatë periudhës 1998-1999 Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë të matur dhe të shtrënguar monetare me synim reduktimin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Ecurinë në zbatimin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë e vlerëson nëpërmjet përcaktimit dhe realizimit të tre objektivave sasiore: kufirit të poshtëm për nivelin e rezervave valutore neto të Bankës së Shqipërisë, kufirit të sipërm për kreditimin neto të qeverisë nga sistemi bankar dhe për mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë.

Në fillim të vitit 1999, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe FMN, u përcaktua si objektiv që të arrihej një normë vjetore inflacioni në fund të vitit prej 7 për qind. Në përputhje me këtë objektiv u konturua dhe programi monetar i Bankës së Shqipërisë. U përcaktua që rritja vjetore e parasë gjithsej (agregati M3) të ishte rreth 15 për qind; kufiri i kreditit për ekonominë dhënë nga sektori bankar të ishte në nivelin e 8 miliardë lekëve, një nivel mjaft liberal krahasuar me vite të mëparshme; kredia për qeverinë të arrinte në nivelin e 27.9 miliardë lekë. Sot, kur ka mbetur dhe një muaj nga përfundimi i vitit 1999 konfirmohet realizimi i objektivave sasiore monetare dhe arritja e një norme negative për inflacionin.

Duke parë zhvillimet pozitive monetare, ecurinë e inflacionit, të vlerës së monedhës kombëtare, gjatë gjithë vitit 1999 Banka e Shqipërisë veproi në drejtim të zbutjes së politikës së saj monetare. Zhvillimet aktuale i kanë krijuar hapësirat për këtë zbutje, megjithëse, që efektet e saj të jenë të prekshme, kërkohet një periudhë kohe më tepër se një vit. Instrumentet që i shërbyen Bankës së Shqipërisë për zbatimin e politikës së saj monetare ishin: përqindja e rezervës së detyrueshme në Bankën e Shqipërisë, kufiri i kreditit mbi sistemin bankar dhe norma dyshme e interesit për depozitat me afat në lekë të vendosura në bankat shtetërore.

#### **3.1. Realizimi i objektivave sasiore monetare.**

Në tërësi vlerësohet se janë realizuar të tre objektivat, madje në nivele më të mira se sa ato të parashikuarat.

Së pari, **rezervat valutore neto të Bankës së Shqipërisë** në fund të muajit tetor kanë arritur në rreth 289 milionë dollarë amerikanë ose rreth 124 milionë dollarë amerikanë mbi kufirin e poshtëm. Rritja e tyre ka ardhur kryesisht nga hyrja e 20 milionë eurove (ose rreth 20.7 milionë dollarë amerikanë) nga Komuniteti Europian për mbështetjen e deficitit ekstrabuxhetor të këtij viti; marrja e transhit të tretë në kuadër të programit ESAF-2 prej 12.8 milionë dollarësh amerikanë; e fondeve të dhëna nga Banka Botërore si dhe e 2.4 milionë dollarëve amerikanë dhënë nga Qeveria e Finlandës si ndihmë për Qeverinë Shqiptare.

Hyrjet e valutave nga jashtë, megjithëse i dhanë një rritje të menjëhershme rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë, nuk patën ndikime në treguesit monetarë në tërësi. Banka e Shqipërisë, për të mos ndikuar në vlerësimin e mëtejshëm të lekut dhe për të frenuar konsumin e popullsisë si pasojë e vlerësimit të të ardhurave të tyre në lekë, ndoqi politikën e shtimit të rezervës valutore dhe nuk ndërhyri në tregun e këmbimeve valutore.

Së dyti, **mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë** në fund të muajit tetor janë rreth 19 miliardë lekë poshtë kufirit të sipërm të vendosur për to për këtë periudhë.

Së treti, objektivi i **kredisë neto të sistemit bankar për qeverinë** shërben për të kontrolluar në mënyrë të tërthortë financimin e brendshëm të deficitit buxhetor. Siç dihet, ky deficit financohet me kredi nga Banka e Shqipërisë dhe nga bankat tregtare. Në fund të muajit shtator, kjo kredi ishte rreth 8 miliardë lekë nën kufirin e sipërm.

Në këtë kuadër, mjaft rëndësi kanë marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me Qeverinë përsa i përket kreditimit të saj. Në tërësi dhënia e kredive nga bankat qendrore për qeverinë është një veprim që çon në rritje të presioneve inflacioniste. Nga ana tjetër, nëse kreditimi bëhet i lirshëm, pa iu nënshtruar rregullave të qarta dhe kufizuese dhe për më tepër kur këto rregulla nuk respektohen, krijohen kushte për reduktim të ndjeshëm të pavarësisë së bankës qendrore.

Në Shqipëri të tilla marrëdhënie rregullohen me ligj dhe me marrëveshje dypalëshe midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave. Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë është e angazhuar të respektojë rigorozisht klauzolat ligjore, si dhe të veprojë në përputhje me filozofinë e saj: politikë monetare e kujdesshme, e shtrënguar që të çojë në reduktim të presioneve inflacioniste.





Kështu, ***pretendimet neto të Bankës së Shqipërisë ndaj qeverisë*** arritën në fund të nëntëmuorit në 66,7 miliardë lekë (nga 64,9 miliardë lekë që ishin një muaj më parë). Arsyeja kryesore për këtë rritje ka qenë pakësimi i depozitës së qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë me 2 miliardë lekë.

Në tërësi, në raport me PBB-në, kredia për qeverinë ka ardhur duke u ulur. Në dhjetor të vitit 1997 ky tregues ishte në nivelin 53 për qind; një vit më vonë, pra në dhjetor të vitit 1998, u ul në 42 për qind dhe në fund të muajit shtator 1999 në 39 për qind. Kjo tendencë duhet konsideruar si një sinjal pozitiv që tregon se është pakësuar pesha e shpenzimeve joproduhuese në totalin e PBB-së.

### **3.2. Kreditimi i ekonomisë për vitin 1999.**

Siç e theksova më lart, kufiri i kreditit i miratuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 1999 ishte mjaft liberal. Ky kufi u shpërnda për të gjitha bankat, përveç atyre shtetërore. Ndërkohë, vlerësohet se edhe për këtë vit kufiri do të realizohet në nivel mjaft të ulët, rreth 16 për qind e tij. Kredia për ekonominë, duke filluar që nga muaji mars ka qëndruar pothuajse në të njëjtat nivele, rreth 18,5 miliardë lekë, dhe pothuajse me të njëjtën strukturë përbërëse.

Kredia në lekë ka ardhur duke u ulur dhe në të njëjtën kohë po rritet ajo në valutë. Në sistemin bankar, në fund të tremujorit të tretë, kredia në valutë zë 44 për qind të stokut të kredisë nga 32 për qind që zinte në dhjetor të vitit 1998. Kjo tendencë është pasojë e faktit që kreditimi i ekonomisë sigurohet vetëm nga bankat private dhe të përbashkëta, të cilat janë të angazhuara në aktivitetin valutor.

Ndoshta, këtu e vlen të diskutojmë pak më gjatë për instrumentin e kufirit të kreditit. Si instrument direkt i politikës monetare, kufiri i kreditit u përdor si një mjet për të kontrolluar kërkesën e parasë. Përdorimi i tij u diktua dhe nga numri i kufizuar i bankave në vendin tonë, tregjet e pazhvilluara të kapitaleve dhe mungesa e rregullave standarde për mbikëqyrjen e bankave.

Në dy vitet e fundit, Banka e Shqipërisë miratoi kufij kredie mjaft liberalë dhe ka lejuar tregtimin e tij midis bankave. Megjithatë, ky kufi nuk u realizua edhe pse numri i bankave të licencuara nga Banka e Shqipërisë u rrit. Në këtë kuadër, gjej rastin të shpjegoj se kufiri i kreditit nuk është bërë pengesë për kreditimin e ekonomisë.

Mbështetur në disa faktorë si:

- \* Kufiri i kreditit nuk është më instrument efikas në kontrollin e kërkesës për para.
- \* Tregu i letrave me vlerë të qeverisë është zgjeruar si përsa i përket numrit të pjesëmarrësve, ashtu dhe operacioneve që kryhen në të.
- \* Është plotësuar kuadri ligjor dhe rregullativ i mbikëqyrjes bankare në lidhje me monitorimin e cilësisë së portofolit të huave, përqendrimin e tyre etj..

Banka e Shqipërisë mori vendimin për të hequr instrumentin e kufirit të kreditit për bankat e nivelit të dytë. Por, do të mbetet kufizimi për bankat shtetërore për të mos shkaktuar kosto shtesë nga dhënia e kredive të pastuduara gjatë periudhës që ato përgatiten për privatizim.

### **3.3. Normat e interesit.**

Ecuria e inflacionit, e kursit të këmbimit, stabiliteti relativ politik e makroekonomik në Shqipëri, mbajtja nën kontroll e zhvillimeve monetare dhe fiskale, por edhe nevoja për të nxitur kreditimin dhe rritjen ekonomike, bënë që Banka e Shqipërisë gjatë dy viteve të fundit të orientohet drejt një zbutjeje të politikës monetare. Kjo është reflektuar në uljen e vazhdueshme të normave dysheme të interesit për depozitat me afat në lekë të vendosura në bankat shtetërore. Një normë e tillë ka fituar statusin e të qenurit normë referencë për të gjitha normat e tjera.

Deri më sot normat e interesit janë ulur gjashtë herë. Normat e interesit për depozitat njëvjeçare janë ulur nga 16.5 për qind në fillim të vitit 1999 në nivelin më të ulët historik prej vitit 1992, në 9 për qind. Megjithatë, në vendimet e saj Banka e Shqipërisë është kujdesur që normat reale të interesit të mbeten pozitive. Kjo ka ndikuar edhe në rritjen e depozitave në sistemin bankar.

Kështu, në muajin shtator ritmi i rritjes së parasë jashtë bankave është ulur mjaft në krahasim me rritjen e muajve të mëparshëm. Nga muaji maj e deri në shtator, raportet “*para jashtë bankave/para gjithsej*” dhe “*para jashtë bankave/depozita*” kanë mbetur në nivele pothuaj konstante, përkatësisht 27 dhe 37 për qind. Pra, rritja e parasë jashtë bankave ka qenë proporcionale me rritjen e depozitave.

Vetë depozitat gjatë nëntë muajve të parë të vitit janë shtuar me rreth 17 për qind. Depozitat në lekë janë rritur me 9.5 për qind. Rritja mesatare mujore e tyre është rreth 1.4 miliardë lekë. Megjithatë, depozitat në



valutë kanë shënuar një ritëm më të lartë rritjeje, kjo si pasojë e veçantive të këtij viti, që u karakterizua nga hyrje të larta në valutë.

Ulja e normave të interesit për depozitat në bankat shtetërore shumë shpejt u ndoq me axhustime të normave të interesit edhe nga bankat e tjera duke krijuar një klimë konkurrence në sistemin bankar për thithjen e depozituesve. Megjithatë, më ngadalë lëvizën normat në krahun tjetër, në atë të kreditimit. Kjo vjen si pasojë e kufizimit në kreditimin në lekë.

Duke parë këtë reagim si dhe duke qenë të ndërgjegjshëm se ecuria e inflacionit për vitin 1999 ka tejkalluar çdo parashikim optimist, Banka e Shqipërisë do të jetë më e matur në të ardhmen në lidhje me vendimet e saj mbi normat e interesit. Ende dhe sot e kësaj dite, ashtu siç e kemi theksuar në deklaratat tona çdo gjashtë muaj, ekzistojnë premisa për përsëritjen e fenomeneve negative të përjetuara më parë dhe ndoshta një ulje e mëtejshme intensive e normës së interesit mund të sjellë pasoja negative.

Nga ana tjetër, politika fiskale, gjithashtu, duhet të jetë më e zbutur në drejtim të shpenzimeve kapitale dhe të kryerjes së investimeve publike. Është e rëndësishme të kërkohet rritje e investimeve në masën 50 për qind.

#### **IV. SITUATA NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR**

##### **4.1. Licencimi.**

Gjatë vitit 1999 ka vazhduar prirja për zgjerim të sistemit bankar e vërejtur prej të paktën që nga viti 1996. Në këtë vit filluan aktivitetin e tyre edhe tri banka të reja: Banka Fefad, Dega e Bankës së Parë të Investimeve (bankë private bullgare) si dhe Banka Ndërtregtare (filial i Bankës Tregtare Greke). Aktualisht, numri i bankave dhe i degëve të bankave të huaja që veprojnë në Republikën e Shqipërisë është 13. Këto janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Tiranës dhe vetëm pak prej tyre (duke përjashtuar rrjetin e bankave shtetërore) kanë çelur degë në qytete të tjera të vendit.

Siç shihet, nga Banka e Shqipërisë në mënyrë të vazhduar janë licencuar banka me kapital të huaj dhe institucione jobankare me kapital vendas. Për periudhën në fjalë nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga subjekte shqiptare, përveç interesimit nga individë të ndryshëm mbi rregullat e licencimit. Mungesa e bankave private me kapital shqiptar mendojmë

se shkaktohet nga një sërë arsyesh:

- \* Investimi në krijimin e një banke nuk është aq fitimprurës sa në aktivitete të tjera si ndërtimi, tregtia etj.. Duhet pranuar që gjatë kësaj dekade u krijua mentaliteti i fitimeve të larta dhe i pasurimit të shpejtë, gjë që nuk e mundëson aktiviteti bankar.
- \* Drejtimi i veprimtarisë së një banke kërkon një ekip të kualifikuar.
- \* Investimi paraprak për të hapur një bankë është i konsiderueshëm. Kjo sepse falimentimi i një banke ka kosto mjaft të lartë, kosto e cila ka natyrën e një kostoje sociale.
- \* Stepja e investitorëve përpara detyrimit për të deklaruar burimin e kapitalit dhe të pasurive të themeluesve të bankës.
- \* Nevoja e paraqitjes së një historiku financiar për një periudhë shtatëvjeçare.
- \* Biznesi bankar është i kontrollueshëm dhe kërkon një nivel të lartë të besimit të publikut dhe të bankave të tjera.

#### **4.2. Situata në sistemin bankar shqiptar.**

Stabiliteti makroekonomik i vendit ka dhënë ndikimin e vet pozitiv edhe në zhvillimin e sistemit bankar.

Megjithatë, mjedisi ekonomik shqiptar vlerësohet të jetë ende me rrezik relativisht të lartë. Në këtë mjedis, bankat, të cilat kanë pak vite veprimtarie, ende paraqiten konservatore dhe tepër të matura në politikën e tyre investuese, sidomos në drejtim të kreditimit dhe të prezantimit të produkteve të reja.

Reformimi i sistemit bankar në Shqipëri është menduar të realizohet nëpërmjet dy drejtimeve: rritjes së numrit të bankave të reja dhe vazhdimit të procesit të privatizimit të bankave shtetërore.

Duke rritur numrin e bankave të reja synohet të reduktohet pesha e bankave shtetërore, të cilat me barrën e problemeve që kanë ndikojnë negativisht në krejt aktivitetin e sistemit bankar. Bankat e reja paraqiten më të suksesshme në drejtim të administrimit të biznesit bankar. Krijimi i më shumë hapësirave për to nxit konkurrencën, ul koston e transaksioneve, ndihmon në krijimin e më shumë mundësive zgjedhjeje për klientët e bankave dhe në zhvillimin e teknologjisë bankare. Kjo do të japë ndikimet e veta në rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së sistemit bankar në tërësi. Nga ana tjetër, privatizimi i bankave shtetërore është karakterizuar nga vonesa dhe shtyrja e vazhdueshme e afateve të përcaktuara për hapat që duhen ndërmarrë.



Banka Kombëtare Tregtare pritet të kalojë përfundimisht në duart e aksionerëve të rinj brenda tremujorit të dytë të vitit 2000.

Më i ngadaltë është procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve për të cilën ende nuk është miratuar formula e privatizimit. Afatet e përcaktuara më parë për hapat që do të ndiqen për kryerjen e këtij procesi po shtyhen vazhdimisht. Përballë kësaj situatë, Ministria e Financave po rrezikon të shkelë nenin 70.2 të ligjit në fuqi "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" sipas të cilit bankat shtetërore, deri në fund të vitit 1999, duhet të marrin masa që të respektojnë normat e mbikëqyrjes. Konkretisht, nga ana e pronarit të tyre ende nuk janë paraqitur programe rehabilitimi dhe rregullimi të veprimtarisë së bankave shtetërore. Nga ana tjetër, shumë pak është bërë për të vendosur marrëdhëniet midis bankave shtetërore dhe buxhetit në pozita tregtare.

Sistemi bankar shqiptar, në veprimtarinë e tij, karakterizohet nga përqendrimi i aktiviteteve, ku peshën kryesore e kanë bankat shtetërore. Për nëntëmujorin e vitit 1999, këto banka përfaqësojnë:

- 66,7 për qind të kredisë gjithsej (ky tregues përfaqëson gjendjen e kredive të dhëna gjatë viteve, pasi aktualisht këtyre bankave u është ndaluar dhënia e kredive);
- 86,1 për qind të totalit të depozitave gjithsej dhe 74.2 për qind e përbëjnë depozitat e individëve. Për periudhën janar-shtator të vitit 1999, krahasuar me fundin e vitit 1998, totali i depozitave në këto banka është rritur 8,6 për qind. Ndërkohë depozitat në lekë të këtyre dy bankave përbëjnë 70,6 për qind të totalit të depozitave gjithsej të krejt sistemit bankar;
- 81.6 për qind të totalit të bilancit;
- 96.8 për qind të totalit të investimeve në portofolin e letrave me vlerë, që përfaqësohen nga bonot e thesarit;
- 94.5 për qind të kredive me probleme.

Problemi kryesor për bankat shtetërore mbetet niveli i lartë i kredive të këqija. Rreth 65,2 për qind e kredisë gjithsej klasifikohet si kredi e humbur. Pikërisht ky përkeqësim i vazhdueshëm i portofolit të kredive bëri që Banka e Shqipërisë të marrë vendimin për të mos lejuar vazhdimin e aktivitetit kredidhënës në këto banka. Kreditimi i realizuar për ekonominë shqiptare gjatë kësaj periudhe është siguruar vetëm nga një pjesë e bankave të tjera. Në fund të muajit shtator të vitit 1999 teprica e kredisë së tyre është rritur rreth 49,8 për qind, krahasuar kjo me fundin e vitit 1998.

Ndërkohë, nëntëmujori për sistemin bankar është mbyllur me fitim për 678,1 milionë lekë nga humbje për 3.3 miliardë lekë që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në këtë nivel fitimi kanë ndikuar:

- rritja me ritëm më të lartë e të ardhurave në raport me shpenzimet. Konkretisht, të ardhurat financiare janë rritur me 33.8 për qind, ndërsa shpenzimet me 13.9 për qind;
- ritme të kundërta ndryshimi në të ardhurat dhe shpenzimet për interesa, të cilat përfaqësojnë kategoritë kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve të sistemit bankar. Konkretisht, të ardhurat nga interesat janë rritur me 7 për qind, ndërsa shpenzimet për interesa janë ulur me 11.4 për qind;
- përmirësimi i strukturës së shpenzimeve për interesa të bankave shtetërore si pasojë e reduktimit të normave të interesit për depozitat me afat në lekë. Për këtë grup bankash shpenzimet për interesa u reduktuan me 13.2 për qind. Kjo ndikoi që rezultati financiar kaloi nga humbje prej 3.4 miliardë lekësh në fund të shtatorit të vitit 1998, në fitim për 0.5 miliardë lekësh në fund të muajit shtator të këtij viti. Ky përmirësim i rezultetit financiar për këto dy banka, për shkak të peshës së tyre në sistemin bankar, ka çuar dhe në përmirësim të treguesve për krejt sistemin.

#### **4.3. Inspektimi në banka.**

Për të siguruar stabilitet të sistemit bankar dhe veprimtari të bankave në përputhje me legjislacionin shqiptar, Banka e Shqipërisë ka kryer një sërë inspektimesh me objekt gjithë veprimtarinë e bankës ose një aspekt të caktuar, të veçantë të saj. Si rregull, inspektimet e plota në banka kryhen çdo 18 muaj. Vitin e ardhshëm ky afat do të ulet në 12 muaj.

Në përgjithësi, nga inspektimet në banka janë vërejtur mangësi të natyrës procedurale dhe të rreziqeve të ndryshme që kanë ndërmarrë ato:

- bankat kanë emëruar ekspertë kontabël të autorizuar pa marrë miratimin e Bankës së Shqipërisë;
- politikat dhe procedurat për të zhvilluar aktivitetin huadhënës dhe për të administruar aktivet dhe pasivet e tyre paraqiten të mangëta;
- bankat nuk kanë nivel të kënaqshëm administrimi dhe kualifikim të kënaqshëm të personelit dhe të drejtuesve të tyre për të administruar zgjerimin e disa operacioneve bankare;
- në banka nuk funksionon mirë komiteti i kontrollit dhe kontrolli i brendshëm;
- në banka është vërejtur dhe mosrespektim i akteve nënligjore të miratuara nga Banka e Shqipërisë.



Të gjitha problemet e mësipërme është e qartë që nuk ekzistojnë në të gjitha bankat. Po kështu, Banka e Shqipërisë ka reaguar duke marrë masat përkatëse korrektuese në përputhje me kompetencat që i jep legjislacioni bankar shqiptar dhe rregulloret që ajo ka miratuar.

## V. PROBLEME DHE OBJEKTIVA PËR VITIN 2000

Bazuar në këtë mjedis relativisht të stabilizuar makroekonomik dhe politik të vitit 1998-1999, objektivat për vitin 2000 mbeten përsëri mjaft optimistë dhe ambiciozë. Parashikohet që për vitin e ardhshëm të realizohet një rritje ekonomike prej 8 për qind, norma vjetore e inflacionit në fund të vitit të arrijë 3 për qind, rezervat valutore të jenë në nivelin e 4.3 muaj importeve, deficitin i llogarisë korente në raport me PBB-në në kufirin 9 për qind.

Bazuar në këta objektiva, Banka e Shqipërisë ka hartuar programin e saj monetar ku përcaktohet një rritje e parasë gjithsej prej 10 për qind. Kjo rritje mendohet se do të jetë e mjaftueshme për të plotësuar nevojat për financim që do të ketë buxheti i shtetit gjatë këtij viti, do të mbajë rezervat valutore në nivelet e kërkuara dhe do të krijojë hapësira për zgjerimin e kreditit në sektorin privat të ekonomisë. Në bazë të ligjit në fuqi "Për Bankën e Shqipërisë", kredia e re që i jepet qeverisë për një vit të caktuar është deri në 5 për qind e të ardhurave mesatare të zakonshme të tre viteve të mëparshme dhe në rrethana të jashtëzakonshme, 8 për qind.

Për vitin 2000, në bazë të vlerësimeve të Ministrisë së Financave mbi të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore, është parashikuar që Banka e Shqipërisë, duke respektuar dhe limitin prej 5 për qind, të japë kredi për qeverinë në masën 4.3 miliardë lekë. Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendimin për të rritur këtë nivel në 6.9 miliardë lekë, brenda kufijve të lejuara me ligj.

Limitet e mësipërme nuk e pengojnë Bankën e Shqipërisë që gjatë vitit 2000, në zbatim të nenit 32 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" dhe bazuar në zhvillimet që mund të vërehen në ekonominë shqiptare dhe në sistemin bankar, të rishikojë programin e vet monetar në drejtim të shtimit të hapësirave kredituese për biznesin si dhe për qeverinë përtej këtyre limiteve. **Por, e theksoj, në çdo rast, çdo rishikim limiti do të jetë në funksion të objektivit kryesor dhe nëse autoritetet do të respektojnë kërkesat e ESAF-2. Çdo hap që do të ndërmerret nuk do të çenojë arritjen e objektivit për inflacionin.**

Që të arrihen këta objektiva është e rëndësishme që të ketë një mbështetje të gjithanshme për të lejuar ekonominë të veprojë. Them kështu sepse mungesa prej tre vjetësh e investimeve dhe krijimi i klimës së pasigurisë për investitorët e huaj, rritja e papunësisë, mosrealizimi i projekteve, janë kosto të cilat ekonomia shqiptare nuk mund t'i mbulojë për periudhë afatshkurtër. Ato do të veprojnë edhe në të ardhmen duke i kufizuar mundësitë për rritje ekonomike të qëndrueshme. Stabiliteti i arritur këta dy vjet ende nuk është konsoliduar dhe mund të konsiderohet si qetësia pas furtunës së vitit 1997. Pa dashur të përsëris fjalë të thëna me qindra herë më parë, por nisur së pari nga shqetësimi im si qytetar i këtij vendi, e theksoj se ekonomia ka nevojë të mbështetet me më shumë rend e qetësi dhe me pak më tepër ndershmëri e korrektësi në administratën shtetërore. Ekonomia jozyrtare, paralele apo e zezë, pak rëndësi ka emri që përdorim, po konkurron egërsisht ekonominë e vendit duke rrezikuar ta vërë këtë të fundit nën kontroll. Nëse nuk bëhen përpjekje sot për të reduktuar peshën dhe veprimtarinë e ekonomisë joformale, nesër mund të jetë vonë ose e pamundur të ndërmerret ndonjë gjë dhe çdo vendim i autoriteteve të vendit do të jetë i destinuar të dalë i paefektshëm.

Treguesi	1997	1998	Shtator 1999
PBB me çmime korente (në milionë lekë)	341.716	456.766	
PBB me çmime konstante	15.325	16.556	
Rritja reale në përqindje	-7.0	8.0	
Struktura e PBB-së (ndryshimi në përqindje)			
Industria	-5.6	...	...
Bujqësia	1.0	...	...
Ndërtimi	-6.3	...	...
Transporti	-20.5	...	...
Të tjera	-25.0	...	...
Inflacioni (norma vjetore në përqindje)	42.1	8.7	-1.77 (tetor 1999)
Numri i të papunëve	193.526	250.000	238.708
Norma e papunësisë	14.9	17.5	18.0
Eksperti (në milionë USD)	158.6	208.0	54.6
Importi	-693.5	-811.7	-252.1
Deficiti tregtar	-534.9	-603.6	-197.5
Deficiti i llogarisë korente në përqindje të PBB	11.1	8.3	
Rezervat valutore në muaj importe	5.3	5.7	5.7
Të ardhurat buxhetore (në milionë lekë)	56.654	93.518	76.676
Shpenzimet buxhetore	100.73	141.628	111.312
Shpenzimet kapitale	13.859	24.215	16.734
Deficiti buxhetor në përqindje të PBB	-12.9	-10.5	-6.3
Financimi i brendshëm	37.726	27.596	12.199
Financimi i jashtëm	6.360	20.513	22.473

Burimi i të dhënave : Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, INSTAT.